

Data 26.07.2023

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Blerje pajisje Informatike (Kompjuter, Printer multifunksional, Printer termik, Printer traktor, Fotokopje A4 me ngjyra, Palmar, Monitor televizori, Barcod Reader)”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): pajisje kompjuterike 30237200-1

VLERA E FONDIT LIMIT:

70.000.000 (shtatëdhjetë milion) lekë pa TVSH.

Në Eur : 684,797 (gjashtëqind e tetëdhjetë e katër mijë e shtatëqindë nëntëdhjetë e shtatë) Euro, pa TVSH

Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë në datën 26.07.2023 është 102.22 Lekë/Euro

Në bazë të nenit 39, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” date 23.12.2020, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor “Posta Shqiptare” SH.A. ka vendosur që kjo procedure të mos jete në lote sipas arsyetimit të mëposhtëm:

Kjo kontrate nuk është ndare në lote pasi administrimi i saj, pra i gjithë bazes materiale objekt kontrate do të administrohet nga Drejtoria e Përgjithshme Posta Shqiptare SH.A, si dhe ndjekja dhe zbatimi i kontrates do të bëhet nga magazina e Drejtorisë së Përgjithshme, ndarja dhe frangmentimi i saj do të krijonte kompleksitet dhe vështiresi në zbatim si dhe do të bente të pazbatueshme kontraten.

Objekti i kontrates lidhet me furnizimin e **Kompjuter, Printer multifunksional, Printer termik, Printer traktor, Fotokopje A4 me ngjyra, Palmar, Monitor televizori, Barcod Reader** janë pajisje të cilat vijnë uniforme për zyrat për të plotësuar të gjithë standartin e sigurisë, për 13 (trembëdhjetë) Filialet e Postes Shqiptare dhe Drejtorisë së Përgjithshme të cilat do të shpërndahen sipas kërkesave të drejtorive/sektoreve/zyrave perkatese, si dhe çdo Filiali ,
Persa me lart ndarja në lote do ta nderlikonte dhe vështiresonte procesin e zbatimit të kontrates duke krijuar vonesa dhe rrjedhimisht do sillte vështiresi për stafin kerkues të bazes materiale. Kjo

kontrate nuk mund te ndahet ne lote pasi ne thelb te gjithe artikujt objekt i kontrates i perkasin te njejtës kategori produktësh.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (ndryshuar), autoriteti/enti kontraktor **Posta Shqiptare sh.a.**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1. Për të garantuar cilësinë e punës gjatë instalimit / konfigurimit të zërave që e kanë të domosdoshëm montimin dhe konfigurimin, operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë staf të kualifikuar me kërkesat minimale si më poshtë:

- Të paktën 1 (një) specialist të certifikuar në nivelin profesional nga prodhuesi për Softëare për monitorimin dhe menaxhimin e platformes virtuale.
- Të paktën 1 (një) punonjes të certifikuar në nivel profesional ITIL (Foundation Certificate in IT Service Managment) ose ekuivalente
- Të paktën 2 (dy) punonjës të profileve inxhinier elektronik/telekomunikacioni /specialist TIK

Për të vërtetuar kriterin e mësipërm, operatori ekonomik duhet të paraqesë diplomat/certifikatat përkatëse të punonjësit si dhe kontratë të vlefshme pune të lidhura midis operatorit ekonomik dhe punonjësit.

Punonjësi duhet të ketë aktualisht një marrëdhënie pune me operatorin ekonomik, e vërtetuar kjo me formularët E-sig te listë pagesave të kontributeve të sigurimeve shoqërore për muajin e fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, të konfirmuar pranë organeve tatimore.

Certifikatat e punonjësit që mund të jenë në gjuhë të huaj, duhet të përkthehen në gjuhën shqipe dhe të noterizohen.

Shenim: *Nje punonjës mund te kete me shume se nje certifikim.*

Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 8.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari, duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Kërkesa lidhet ngushtë me specifikimet teknike për platformën software, lidhur me menaxhimin në mënyrë të pavarur. Është në të drejtën e Autoritetit Kontraktor të kërkojë garanci për realizimin me sukses të projektit, duke përfshirë kërkesat për një staf të kualifikuar i cili ti përgjigjet më së miri nevojave të AK për përmbushjen e projektit.

Kërkesat e stafit teknik lidhen me nevojën për staf të specializuar për të realizuar detyrat specifike të projektit: dizenjimi teknik, instalimin, monitorimin e burimeve që kërkon në vijimësi sistemi, aksesin në sistem, dhe mirëmbajtjen tërësore të sistemit. Të garantojë sigurinë e sistemit përmes politikave të aksesit së bashku me stafin e AK-së, të garantojë kryerjen e detyrave specifike, integrimi me rrjetin dhe shërbimet ekzistuese, instalim përfundimtar i sistemit në ambientin ku do funksionojë si dhe të ngrejë dhe përdorë ambiente virtuale të instalimit.

Është në të drejtën e Autoritetit Kontraktor të kërkojë garanci për realizimin me sukses të projektit, duke përfshirë kërkesat për një staf të kualifikuar i cili t'i përgjigjet më së miri nevojave të tij për përmbushjen e projektit.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore financiare të 3 (tre) viteve të fundit, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 99% e vlerës së fondit limit**. *Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra 99% e vlerës së fondit limit, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (ndryshuar). Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar është në përpjestim të drejtë me fondin limit të procedurës. Kërkesat e mësipërme i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjëndjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

2.3Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 39 % të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) Vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë një vlerë jo më të vogël se 39 % të vlerës së përllogaritur të kontratës, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Duke marrë në konsideratë sasine dhe cilesine e mallrave të kërkuar në këtë objekt procedure prokurimi, është menduar se vlera e kërkuar që OE ofertues të kete realizuar me kontrata të ngjashme, të jete afer limitit maksimal dhe në kete menyre, AK krijon sigurine dhe besueshmerine që OE ofertues mund të realizojë kontratën objekt prokurimi me sukses dhe pa patur pengesa të ndryshme që do të ndikonin në ecurine e punes së AK.

2.3.2. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se ushtrojnë aktivitetin e tyre tregtar në fushën objekt prokurimi duke zbatuar normat e certifikimit ISO si më poshtë:

- a) Certifikatë **ISO 9001:2015 (ose e përditësuar)** mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë”;
- b) Certifikatë **ISO 27001: 2013 (ose e përditësuar)** mbi “Menaxhimin e sigurisë së informacionit”;

Certifikata e kërkuar duhet të paraqitet origjinale ose kopje e noterizuar, e lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: Këto kritere u vendosën në përputhje me parashikimin e nenit 36 dhe nenit 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenit 44, të VKM-se Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, në bazë të Njoftimit të Agjencisë së Prokurimit Publik Nr.2502 Prot., datë 09.04.2021, si dhe ligjit nr. 116/2014 “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë”, ku përcaktohet se kjo Certifikatë duhet të jetë lëshuar nga organizma certifikues të akredituar, me qëllim që enti prokurues të krijojë sigurinë që operatorët ekonomik ofertues i kanë kapacitetet teknike lidhur aftësinë e tyre për të kryer shërbimin objekt kontratë. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente.

Kërkesa për certifikime sipas standardeve ISO janë në vetvete një garanci më tepër për suksesin e projektit, në lidhje me cilësinë e produktit dhe shërbimeve, sigurinë e informacionit gjatë zhvillimit, gjatë instalimit e konfigurimit dhe në lidhje me menaxhimin, kuptimin dhe përkthimin e proceseve të biznesit në procese IT.

2.3.3 Operatorët ekonomikë ofertues duhet të plotësojnë dhe të dorëzojnë së bashku me dokumentet e tjera, skedën teknike për artikujt objekt prokurimi, sipas tabelës së mëposhtme:

A	B	C	D
Nr.	Emërtimi i artikullit	Kompania prodhuese	Specifikimet teknike referuar katalogëve/prospekteve
1	Kompjuter		
2	Printer Multifunkionale		
3	Printer Termik		
4	Printer Traktor		
5	Fotokopje A4 me ngjyra		
6	Palmar		

8	Barcod Reader		
----------	---------------	--	--

Konkretisht në kolonën **D**, të skedës teknike, operatorët ekonomikë duhet të japin një përshkrim të plotë të karakteristikave teknike për artikujt e specifikuar, karakteristika këto që duhet të përputhen me specifikimet teknike të kërkuara. (Numrat rendor i referohen numrave të artikujve sipas tabelës në shtojcën 6 "Formulari i sasisë dhe grafikut të lëvrimit".)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 6/b, të nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar. Ky kriter është vendosur për ti dhënë sigurinë AK që OE ofertues, me anë të kësaj skede teknike, të garantojnë Autoritetin Kontraktor se artikujt e ofruar do të jenë prodhim i të njëjtës kompani me atë të deklaruar në ofertë dhe që përmbushin kërkesat e specifikimeve teknike.

2.3.4. Operatorët ekonomikë ofertues duhet të paraqesin katalogët/prospektet e prodhuesit për të gjithë artikujt e përfshirë në **skedën teknike**.

Argumentimi : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 6/b, të nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar. Ky kriter është vendosur për ti dhënë sigurinë AK që OE ofertues do të paraqesë mallra, të cilët përmbushin kërkesat e specifikimeve teknike dhe janë në përputhje me to.

2.3.5. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të provojnë që janë të autorizuar nga *prodhuesit* ose nga *distributorët e autorizuar nga prodhuesit*, për tregtimin e artikujve objekt prokurimi (sipas tabelës së përcaktuar në pikën **2.3.3**, të kriterëve të veçanta për kualifikim) ku te jete ne përputhje me specifikimet teknike. Në rast se do të paraqitet autorizim nga distributorë të autorizuar, duhet të vërtetohet lidhja midis Distributorit të Autorizuar dhe Prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, e-mail, website kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

Argumentimi : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe pikën 6, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar. Kjo kërkesë është vendosur :

- për të rritur sigurinë dhe bindjen e AK se ofertuesit janë të aftë të realizojnë kontratën në rast se shpallen fitues, për shkak të natyrës së veçantë të artikujve objekt prokurimi dhe
- për të garantuar AK se oferta teknike është e bazuar në produkte reale të identifikuar nga ofertuesit.

Kriteri është në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë teknike dhe i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së ofertuesve për përmbushjen me sukses të kontratës.

2.3.6. Për Integrimin e platformës së produktit Palmar me platformën e menaxhimit në Cloud, ofertuesi duhet të paraqesë dokumentacionin që vërteton integrimin e tyre. Në rast se janë produkte nga prodhues të ndryshëm, ofertuesi duhet të paraqesë vërtetim nga secili prodhues për integrimin e tyre. Mos paraqitja e vërtetimeve nga prodhuesit është kusht për skualifikim.

Argumentimi: Dokumentacioni i kërkuar është një dokument i rëndësishëm, pasi përveçse tregon kanalin zyrtar të origjinës së mallrave/licensimeve specifike që kërkohen në kete prokurim, na garanton gjithashtu se produkti(platfome) e ofruar integrohen me njeri tjetrin. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të produkteve që kërkohen të blihen e që janë prodhuar/krijuar sipas standardeve më të larta nga prodhues të zyrtarizuar. Ky kriter është jo diskriminues, është në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë shitëse dhe teknike. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për përmbushjen me sukses të kontratës, duke vërtetuar se produktet e kerkuara integrohen me njera tjetren. Duke qenë se ky prokurim është ndërtimi i një sistemi të ri që duhet të ketë vazhdimësi për tek AK, Operatoret Ekonomike duhet specifikisht të paraqesin dokumentacion mbi integrimin e tyre nga kanali zyrtar përkates me qëllim që te garantojnë Autoritetin Kontraktor në mënyrë që të sigurohet vazhdimësia e procesit si dhe suportit teknik.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shënim: Në respekt të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, në të gjithë rastet në kur dokumentet e tenderit përmendet “markë” përfshihet termi “ose ekuivalenti i tij/saj”.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

VLERA LIMIT E KONTRATËS,

Vlera Limit e kontratës, duke qenë se nuk ka çmime të botuara nga INSTAT-i, ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse, grupi i punës u bazua në çmimet e tregut, e bazuar në nenin 76 “**Mënyrat për përllogaritjen e vlerës së prokurimit**”, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimeve Publike” (i ndryshuar) ku parashikohet se:

- 1. Në përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti/enti kontraktor duhet t’i referohet një ose më shumë alternativave të renditura, si më poshtë vijon:*
 - a) çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj.); ose/dhe*
 - b) studimit të tregut, bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim; ose/dhe*
 - c) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe*
 - ç) çmimet ndërkombëtare të shpallura publikisht.*

Autoriteti/enti kontraktor mund t’i referohet një ose me shumë alternativave të mësipërme në përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, me qëllim që ajo të jetë një vlerë reale për kushtet e tregut dhe njëkohësisht të krijojë mundësinë e pjesëmarrjes së sa më shumë operatorëve ekonomikë.

Specifikimet teknike fondi limit dhe kriteret e vecanta per kualifikim jane hartuar nga strukture e posacme e ngritur me urdher te titullarit te autoritetit kontraktor.

Njësia e Prokurimit: